



21.02.2024

## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:242625

Datë: 19.01.2024

Numri i dokumentit: 05308878

C.nr.895/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Lendita Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Enes Goga nga Peja, Rr. "Mbreti Bardhyl", 49/B, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Durim Osmani, avokat në Prishtinë, kundër të paditurave Gazeta e Përditshme "Zëri" me seli në Prishtinë dhe Arbana Xharra, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Lekë Morina, bashkëpunëtor i lartë profesional në Shoqërinë e Avokatëve "Koci & Vokshi" në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial për shkak të shpifjes dhe fyerjes, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 27.12.2023 në të cilën ishin të pranishëm paditësi me të autorizuarin e tij dhe i autorizuari i të paditurave, me datë 19.01.2024 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Enes Goga, nga Peja, me të cilën ka kërkuar të:  
*"I. Detyrohet Gazeta "Zëri" që Enes Goga ti kompensoj dëmin jo material në shumë prej 20,000.00 € pa kamatë ligjore, në këto rrethana 10,000.00 € për shkak të cenimit të autoritetit, 5,000.00 € për shkak të cenimit të nderit, 5,000.00 € për shkak të shkakimit të dhembjeve shpirtërore.*  
*II. Detyrohet Arbana Xharra që Enes Goga ti kompensoj dëmin jo material në shumë prej 20,000.00 € pa kamatë ligjore, në këto rrethana 10,000.00 € për shkak të cenimit të autoritetit, 5,000.00 € për shkak të cenimit të nderit, 5,000.00 € për shkak të shkakimit të dhembjeve shpirtërore"* e PABAZUAR.
- II. DETYROHET paditësi Enes Goga nga Peja që të paditurave Gazeta e Përditshme "Zëri" me seli në Prishtinë dhe Arbana Xharra, në emër të shpenzimeve të procedurës t'ua paguajnë shumën e përgjithshme prej 312.00 €, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Paditësi Enes Goga përmes të autorizuarit të tij me datë 25.04.2016, ka ushtruar padi kundër të paditurave Gazeta e Përditshme "Zëri" me seli në Prishtinë dhe Arbana Xharra, për kompensimin e dëmit jomaterial për shkak të shpifjes dhe fyerjes.

Paditësi në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka theksuar se me datë 06.04.2016 rreth orës 15:25 e paditura e parë ka publikuar në web faqen e saj lajmin me titull *“Imamët e dyshuar për Terrorizëm po përgatisin fushat Denigruese kundër Imamëve Modern”*, përmes të cilit të paditurat kanë përhapur të dhëna të pavërteta, e të cilat njëkohësisht janë edhe fyerje ndaj tij. Për lajmin në fjalë paditësi ishte njoftuar me datë 15.04.2016. Ka theksuar se në lajmin e publikuar ishte theksuar se Enes Goga është lider i lëvizjes vahabiste në regjionin e Pejës, e cila lëvizje është e lidhur me krimin e organizuar, trafiqet e drogës, haraçin ndaj bizneseve, shantazhin, rrahjet brutale, etj. Pastaj se lideri i lëvizjes vahabiste ka siguruar qasje në Prokurorinë e Shtetit dhe ka në shërbim pjesëtarë të Policisë së Kosovës, të cilët ju sigurojnë informacione të klasifikuara brenda dosjeve policore, e të cilat informacione përdoren kundër imamëve të moderuar brenda Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe se tani paditësi është suspenduar nga pozita e tij e Kryeimam në Komunën e Pejës në BIK dhe se është i dyshuar për përdhunim të varrezave, e që sipas tij janë shpifje dhe fyerje e rëndë ndaj tij. Tutje ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet se ai është i dyshuar për veprën penale *“Dëmtim i varreve apo kufomave”* nga neni 421 paragrafi 1 i KPK, ose se është duke u zhvilluar ndonjë procedurë ndaj tij, dhe se i njëjti është suspenduar nga pozita e Kryeimamit në Komunën e Pejës në BIK. Me përhapjen e fakteve të pavërteta me rastin e publikimit të lajmit në fjalë është dëmtuar seriozisht reputacioni i tij, përkatësisht është cenuar autoriteti si kryeimam por edhe nderi si qytetar i kësaj Komune, andaj Gjykatës i ka propozuar që t’i detyroj të paditurat që t’ia kompensojë paditësit dëmin e shkaktuar për dëmtim të nderit dhe reputacionit secila veç e veç në shumë prej 20,000.00 €.

Në fjalën e tij përfundimtare paditësi ka theksuar se lajmi i kontestuar i publikuar me datë 06.04.2016 është i pavërtetë si dhe është nxjerr në shpërfillje të plotë me të vërtetën, me mundësin e gjetjes së të vërtetës si dhe duke shkelur rregullat e kodit të etikës për mediat e shkruara. Ka theksuar se të paditurat para publikimit të lajmit nuk kanë ndërmarr veprime për vërtetimin e fakteve të publikuara në lajm në mënyrë të sigurtë ose duke e përjashtuar çdo mundësi që lajmi të mos jetë i vërtetë, pasi që nuk kanë siguruar qasjen dhe versionin për lajmin nga tani paditësi. Pastaj ka theksuar se me rastin e publikimit të lajmit pala e paditur ka përdoruar një gjuhë të pabalancuar, me ngjyrimë dhe pa dalluar opinionin e saj me faktet që pretendohen në lajm. Të paditurat kanë pasur për detyrë të vërtetojnë pretendimet e tyre për raportin e inteligjencës ndërkombëtare në të cilin e kanë bazuar lajmin. Detyrimi për vërtetimin e fakteve si barrë e të provuarit nuk përjashtohet në interesin e palës së paditur në emër të mbrojtjes së burimit. Sipas tij të paditurat pretendojnë se raporti i inteligjencës ndërkombëtare nuk është opinion por lajm i vërtet dhe se këtë dokument të paditurat e kanë pasur, por çuditërisht nuk e ka dorëzuar si provë në këtë seancë. Ky fakt vërteton se padia e paditësit është e bazuar, se të paditurat kanë përgjegjësi për shpifje nga se lajmi nuk është vërtetuar se është i vërtet apo si ka mundur të jetë i vërtet, e po ashtu lajmi duke marr parasysht përmbajtjen përveç se është i pavërteta e dëmton imazhin e palës paditëse. Duke marrë parasysht të lartcekurat gjykatës i ka propozuar ta aprovoj në tërësi të bazuar kërkesëpadinë në fjalë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar

Të paditurat përmes të autorizuarit të tyre në përgjigjen në padi dhe gjatë seancave gjyqësore, e kanë kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Sipas tyre artikulli në fjalë nuk i drejtohet Enes Gogës si individ i cili ka siguruar qasje në Prokurorinë e Shtetit dhe në Policinë

e Kosovës, mirëpo ky artikull flet në përgjithësi për pjesëtarët e këtij grupit duke mos iu referuar në asnjë pikë paditësit si vijë ndërlidhëse e këtij grupi vahabist me Prokurorinë e Shtetit dhe me Policinë e Kosovës. E që sipas tyre paditësi në këtë formë paraqet të pavërteta të cilat asnjëherë nuk janë thënë në artikull. Tutje i konsiderojnë të pabazuara pretendimet e paditësit se artikulli ka mungesë të profesionalizmit duke qenë se artikulli bazohet në Raportin e Inteligjencës i karakterit ndërkombëtar e ku thuhet se Enes Goga ishte lider i lëvizjes vahabiste/salafiste në Pejë. Lidhur me këtë dhe përjashtimin e përgjegjësive së të paditurve vlen të theksohet se të paditurit i janë referuar edhe një hulumtimi paraprak të zhvilluar nga “Gazeta Express” të publikuar me datë 07.12.2013, pra tri vite para publikimit të artikullit kontestues, e cila në hyrje të saj citon se tani paditësi “*po hetohet ndër të tjera edhe për dhunimin e varrezave*”. E poashtu sipas tyre është e pakontestueshme se paditësi ka qenë i arrestuar dhe i dyshuar për veprimtari të lidhura me terrorizmin dhe nxitjen e urrejtjes fetare. Kanë shtuar se i gjithë artikulli i atakuar përdorë gjuhë të balancuar, në përputhje me etikën e gazetarisë dhe në përputhje me interesin publik, ngase ai është i bazuar në burime të caktuara të cilat bazuar në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë janë të mbrojtura. Tema për të cilën është shkruar është jashtëzakonisht e ndjeshme dhe është interes i publikut që të jetë i informuar për të gjitha këto ngjarje. Kanë theksuar se publikuesi në artikullin në fjalë është bazuar tërësisht në burimet veta. Për më tepër përveç burimeve të fshehta të cilat janë normale në gazetarinë hulumtuese i padituri është bazuar edhe në informata publike, siç janë komunikatat zyrtare të prokurorisë. Shkrimi është i bazuar edhe në Raportin e Departamentit të Shtetit për lirinë fetare, raport ky i cili ka zgjuar dyshime pasi që kishte përmendur disa imamë kosovar me pozita drejtuese që i përkasin kësaj lëvizjeje për përhapjen e urrejtjes ndërfetare dhe anti-semitizëm. Të paditurat me qëllim të kundërshtimit të pretendimeve të paditësit lidhur me pavërtetësinë e artikullit kontestues, si provë për disa deklaramë në artikullin në fjalë i referohej artikullit “*vahabistët e Pejës merreshin me harraq e drogë*” të publikuar nga “Kosova Info” me datë 30.09.2014. Në këtë drejtim ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit për dëmin jomaterial nuk ka bazë juridike, ndaj edhe kanë propozuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Në fjalën e tyre përfundimtare të parashtruar me shkrim, të paditurat kanë theksuar se padia e paditësit e datës 25.04.2016, hyn në radhën e Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (ang. Strategic Lawsuit Against Public Participation – “SLAPP”). Paditë SLAPP janë padi abuzive dhe qartazi të pabazuara, qëllimi kryesor i së cilave është parandalimi, kufizimi, penalizimi apo frikësimi i gazetarëve nga pjesëmarrja publike në çështje të interesit publik. Kanë theksuar se paditësi ka procese të panumërta gjyqësore ndaj gazetarëve dhe konkurrentëve të tij me objekt të njëjtë kontesti, duke përfshirë por pa u kufizuar ku përveç lëndës në fjalë janë kontestet e listuara si në vijim: lënda C.nr. 162/16 – Enes Goga kundër Visar Duriqi, C.nr. 3321/14 – Enes Goga kundër Visar Duriqi, NB Media Works, Gazeta “Zëri”, C.nr. 2090/15 – Enes Goga kundër Gazeta “Zëri”, C.nr. 723/19 – Enes Goga kundër Drilon Gashi (GJTH Pejë), C.nr. 849/19 – Enes Goga kundër Zyhdi Hajzeri (GJTH Pejë), e të cilat kanë disa elemente të përbashkëta. Të gjithë artikujt e kontestuar janë shkruar në një periudhë të caktuar kohore (2014-2016), kur akuzat dhe proceset gjyqësore penale ndaj paditësit Enes Goga kanë qenë çështje të interesit publik pasi që i njëjti, duke qenë figurë publike dhe shpirtërore, akuzohej për terrorizëm. Element tjetër i përbashkët është përmbajtja e ngjashme e artikujve/shkrimeve kritike dhe investigative të gazetarëve dhe mediave, përkatësisht mbulimi i së njëjtës tematikë. Dhe së fundmi, të gjitha kontestet e lartshënuara kanë objekt kompensimin e dëmit (joproporcional) të

pretenduar nga shpifja apo fyerja. Sipas tyre, padia e paditësit për kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes është e pabazuar, pasi që ekziston baza për përjashtimin e të paditurave nga përgjegjësia për shpifje. Të paditurat përgjatë gjithë procedurës kanë argumentuar se për secilën deklaratë të kontestuar kanë vepruar me përgjegjësi. Kanë theksuar se sipas praktikës gjyqësore lajmi i publikuar më herët mund të shërbej si burime e që është konstatuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Rev.nr.390/2023.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: kopjen e artikullit “Imamët e dyshuar për terrorizëm po përgatisin fushate denigruese kundër imamëve te modernizuar” të publikuar në web faqen e gazetës “Zëri” të datës 06.04.2016, vërtetimin e lëshuar nga Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Përgjithshme PP.II.Nr.1962/13 i datës 26.11.2015, Vendimin me numër 33/16 i datës 07.01.2016, ankesë për përmirësimin e shprehjeve në lajm dhe heqje të lajmit nga web faqja e Gazetës “Zëri”, kopja e vërtetimit mbi pranimin e dërgesës për Komisionin e Pavarur për Media e datës 18.04.2016 dhe Gazeta “Zëri” e datës 18.04.2016, shënimet nga raporti inteligjencës ndërkombëtare, kopjen e artikullit të publikuar në “Gazetën Express” me titull “Ja për çka po hetohet krye imami i Pejës Enes Goga” i datës 07.12.2013, kopjen e artikullit të publikuar në “Kosova Info” me titullin “Vehabistët e Pejës po merreshin me harraq e drogë” i datës 30.09.2014, vërtetimin e lëshuar nga Prokuroria Themelore në Pejë PPP.II.Nr.1189/15 i datës 02.06.2022, si dhe është dëgjuar paditësi Enes Goga në cilësi të palës.

Në këtë çështje juridike objekt kontesti është publikimi i datës 06.04.2016 në portalin e gazetës “Zëri”, nga të paditurat Arbana Xharra, në cilësi të gazetares dhe Gazetës “Zëri” në cilësi të publikuesit, me titull “Imamët e dyshuar për terrorizëm po përgatisnin fushatë deintegruese kundër imamëve të moderuar”.

Në artikull theksohet se “Një operacion i ri i lëvizjes vahabiste në Kosovë, në krye të së cilës është Imami Enes Goga përfshin fushat deitegruese kundër imamëve të moderuar”, e që më tej ka vazhduar “Imamët radikal disa prej të cilëve para dy vitesh janë arrestuar me dyshimin se kanë nxitur terrorizmin dhe urrejtjen fetare pretendojnë se kanë arritur të sigurojnë qasje dhe informacione konfidenciale nga Prokuroria e Shtetit dhe dosjet e Policisë së Kosovës”. Pastaj “Burimet bëjnë me dije që në kuadër të këtij operacioni të lëvizjes vahabiste në Kosovë, kjo lëvizje ka arritur të siguroj qasje edhe në dosjet e Prokurorisë së Shtetit dhe ka në shërbim pjestarë brenda Policisë së Kosovës, që po iu ofrojnë informacione të klasifikuara brenda dosjes policore që do të përdoren për qëllim deintegrimit të imamëve të moderuar.”

Tutje në artikull theksohet se “Një raport i inteligjencës ndërkombëtare i publikuar më parë kishte bërë me dije që Enes Goga ishte lider i lëvizjes vahabiste/slfiste në Pejë regjion në të cilin hetuesit e inteligjencës ndërkombëtare konstatojnë se kjo rrymë ka arritur të krijoj kampe rekrutimi të xhihadistëve, Ky raport i publikuar konstaton se lëvizja vahabiste në Pejë është e lidhur me krimin e organizuar prej trafikëve të drogës e deri te haraçi kundër bizneseve, derisa nuk përjashtohet implikimi i pjesëtarëve të kësaj lëvizje edhe në krime si shantazhi e deri tek rrahjet brutale të pjesëtarëve të besimeve të tjera”.

Në vijim të shkrimit, theksohet se *'siç bëjnë me dije burimet brenda BLK-ut ai tashmë është i suspenduar nga udhëheqësia e Bashkësisë Islame të Kosovës. Pjesë e dënimit të tij është edhe zbritja e pagës prej 20 % deri në vendim të komisionit disiplinor në organizatën që ka përsipër emërimin dhe shkarkimin e imamëve nëpër të gjitha xhamitë e Kosovës'*. Poshtu në artikull ceket se *"[...] Enes Goga në vitin 2014 u arrestua për veprimtari të lidhura me terrorizmin ku ka qëndruar disa javë në burg, derisa ai ka qenë nën hetime edhe për përdhunim të varrezave – konfirmime të prokurorisë për media"*.

Sipas kërkesës së tani paditësit Enes Goga, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Përgjithshme me datë ka 26.11.2015 ka lëshuar Vërtetimin PP.II.Nr.1962/13, përmes së cilës ka konfirmuar se me datë 04.05.2015 i ka pushuar hetimet kundër të dyshuarit Enes Goga i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Dëmtim i Varreve apo kufomave" nga neni 421 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që gjatë fazës së hetimeve nuk kanë gjetur prova të mjaftueshme të cilat do të vërtetonin faktin si i dyshuari ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet.

Sipas kërkesës së tani paditësit Enes Goga, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Përgjithshme me datë ka 02.06.2022 ka lëshuar Vërtetimin PPP.II.Nr.1189/2015, përmes së cilës ka konfirmuar Policia e Kosovës, sektori i Hetimeve në Pejë, në PTH në Pejë me datë 23.11.2015 ka ushtruar kallëzim penal që evidentohet me shenjen 2015-DA-2839, kundër personit NN me dyshim se i njejtë ka kryer veprën penale "zjarrëvënie" nga neni 334 të KPRK-së. dhe në këtë çështje parashtruesi i kërkesës nuk është i përfshirë as si i dyshuar, i dëmtuar apo dëshmitar.

Portali "Gazeta Express", me datë 07.12.2013, kishte publikuar një artikull me titull *"Ja për çka po hetohet krye imami i Pejës Enes Goga"*. Nga kjo provë vërtetohet se në këtë shkrim, portali Gazeta Express, duke iu referuar konfirmimit nga Prokuroria e shtetit ka theksuar se tani paditësi Enes Goga është duke u hetuar për dy vepra penale si kanosje dhe dhunim i varrezave.

Portali "Kosova Info", me datë 30.09.2014, kishte publikuar një artikull me titull *"Vehabistët e Pejës po merreshin me harraq e drogë"*. Nga kjo provë vërtetohet se në ballinën e këtij shkrimi, portali ka theksuar se *"haraç, drogë, kampe të rekrutimit, shpëlarje e parave, pasuri e pashpjegueshme, dhunë fizike, ... janë vetëm disa nga krimet që besohet ti kenë kryer vehabistët në qytetin e Pejës, një qytet me shkallë të lartë të kriminalitetit. Ata janë të lidhur me vahabistët në regjion, derisa drejtohen nga krye imami Enes Goga (tash i arrestuar)*. Sipas këtij shkrimi këto janë gjetje të një hetimi disa vjeçar të inteligjencës ndërkombëtare, dosje të cilat i ka parë "Express" dhe e cila është mbyllur në vitin 2013, kur besohet se hetimi për vehabistët kaloi nën duar të Prokurorisë. Tutje theksohet se Enes Goga është në paraburgim nën dyshimin për nxitjen e urrejtjes në një grup prej 11 imamësh.

Përmes *"shënimeve nga raporti inteligjencës ndërkombëtare"*, të paditurit kanë pretenduar të dëshmojnë burimin e informacioneve, e ku theksohet se Enes Goga është imam i Xhamisë Mesxhidi i Madh në Pejë dhe është person kryesor i grupit islamik radikal Vehabi në Pejë, Shpesh udhëton në Arabinë Saudite, kurse me datë 11.02.2008 ka shkuar në Angli dhe është kthyer me datë 16.02.2008. Pastaj theksohet se Enes Goga është krye imam i Pejës dhe

njëkohësisht edhe udhëheqës i grupit ekstremist Vehabist për regionin e Pejës dhe dyshohet se ky krye imam është duke u marrë fajde. Gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e kësaj prove duke qenë se e njëjta nuk përbante të dhëna se kur dhe ku janë marrë këto shënime.

Paditësi Enes Goga në cilësi të palës para gjykatës ndër të tjera ka deklaruar se artikulli i kontestuar përmban përplot shpifje e të pavërteta dhe se gazetarja Alban Xharra nga viti 2012 në mënyrë të vazhdueshme është marrë me Institucionin ku ai punon, pastaj me të dhe familjen e tij. Dhe se shkrimet e saj jo rrallë herë kanë nxitur edhe reagime dhe urrejtje e mllëfe prej të tjerëve ndaj personalitetit të tij, dhe se ai dhe familja e tij janë ndjerë të rrezikuar prej këtyre shkrimeve, kryesisht në rrjetet sociale. Ka theksuar se nuk është kontaktuar nga të paditurat as para dhe as pas publikimit të artikullit. Sipas tij ai në KBI në Pejë mban pozitën e kryeimamit dhe se nuk ka asnjë ndikim në BIK, derisa me rastin e pranimit të punëtorëve të rinj respektivisht imamëve, rregullorja e BIK-ut i detyron KBI të kryej vetëm procedurat teknike, formale e administrative, ndërsa emërimet e tyre bëhen nga BIK. Ka shtuar se artikulli në fjalë ka pasur ndikim tek ai dhe familja e tij, duke qenë se jetojnë në një vend të vogël ku të gjithë njihen në mes vete dhe se për një kohë të gjatë i kanë kërkuar sqarime lidhur me këto të pavërteta. Dhe se javët e para nuk kanë munguar ekzaminimet mjekësore pasi që nuk ishin të lehta për të, por ka pasur fatin që e ka mjekun në shtëpi (pasi që bashkëshortja e tij është mjeke). Ka theksuar se deklaratime të ngjashme si në këtë artikull se është lider i lëvizjes vahabiste ka pasur edhe më herët si në një artikull të gazetarit Visar Duriqi të botuar në “Gazeta Express” në vitin 2014. I njëjti ka theksuar se është qytetar i Republikës së Kosovës, shqiptar i besimit mysliman, dhe se veten nuk e identifikon si pjesëtar i lëvizjes vahabiste. E ka pohuar se në vitin 2016 komisioni disiplinor i BIK i ka shqiptuar masë me ndalim të pagës për 9 muaj.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në këtë shqyrtim gjyqësor, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Duke qenë se padia e paditësit ka të bëjë me kërkesën për kompensimin e dëmit në emër të shpifjes dhe fyerjes, Gjykata gjeti se, në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (LCKSHF), si ligj i veçantë, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil.

Me nenin 3 pika a) të LCKSHF-së është definuar se: “Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklaratat është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.” Ndërsa, në pikën b) të kësaj dispozite përcaktohet se: Fyerja nënkupton deklarin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.”

Lidhur me përgjegjësinë për shpifje dhe fyerje në nenin 5 paragrafi 1 të LCKSHF parashihet se: “Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj”. Ndërsa, në paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se “Kur shpifja ose fyerja ka të bëjë me një çështje të interesit publik ose kur personi i shpifur ose fyer është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për një pozitë publike, mund të ketë përgjegjësi

*për shpifje ose fyerje vetëm nëse autori ka ditur se informacioni ka qenë i rrejtshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij.”*

Kushtetuta e Kosovës në Neni 40 [Liria e Shprehjes], ka paraparë se:

- 1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*
- 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*

Me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), (e zbatueshme drejtpërdrejtë sipas Nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës), parashihet se:

*(1) Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.*

*(2) Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”*

Paditësi ka pretenduar se të paditurat përmes artikullit objekt i këtij kontesti kanë përhapur lajme të pavërteta e të cilat njëkohësisht janë fyese, ashtu që i ka shkaktuar dëme jomateriale për shkak të dëmtimit reputacionin dhe autoritetit të tij.

Në vlerësimin e kërkesëpadisë së paditësit, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, konform nenit 2 të LCKSHF dhe nenit 53 të Kushtetutës, sipas të cilave Gjykata është e detyruar që të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me këtë Ligj, në harmoni me vendimet e GJEDNJ.

Në këtë drejtim, GJEDNJ ka theksuar se “*Liria e shprehjes përbën një nga themelet kryesore të një shoqërie demokratike, dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për përmbushjen vetjake të çdo individi*” (shih rastin e GJEDNJ *Handyside kundër Britanisë së Madhe*, Aktgjykimi i datës 7 Dhjetorë 1976, paragrafi 49; *Lingens kundër Austrisë*, 1986, Aktgjykimi i datës 8 Korrik 1986, paragrafi 41; si dhe rasti *Sener kundër Turqisë*, Aktgjykimi i datës 18 Korrik 2000, paragrafi 39).

Duke iu referuar parimeve të ndërtuara në jurisprudencën e GJEDNJ, Gjykata e sheh të përshtatshme të vlerësoj si në vijim: kontributin në një debat me interes publik; sa i njohur është

personi në fjalë dhe cila është përmbajtja e deklaratës; sjelljen e tij të mëparshme; përmbajtjen, formën dhe pasojat e deklaratës. Duke qenë se kjo Gjykatë, gjykon si gjykatë e faktit në shkallë të parë, vlerëson se kriteri i pestë që i referohet ashpërsisë së sanksionit, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në vlerësimin e rastit.

Gjykata vlerëson se temat e trajtuara në artikullin që është objekt i gjykimit, e që ndërlihet kryesisht me aktivitetet e pjesëtarëve të lëvizjeve fetare paraqesin çështje të interesit të përgjithshëm publik.

Bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, por edhe deklaratimet e vet paditësit, Gjykata gjen se paditësi ka pasur dhe ka rol aktiv në jetën fetare në Kosovë, pasi që mban pozitën e kryeimamit në Këshillin e Bashkësisë Islame në Pejë. Ndaj sipas vlerësimit të Gjykatës paditësi është person i njohur për publikun, dhe si i tillë do të konsiderohet person publik, andaj, kufijtë e kritikës së pranueshme duhet të jenë më të gjera sesa në rastin kur objekt kontesti mund të jenë deklaratimet apo publikimet ndaj një individi privat. Bazuar edhe në shkresat e lëndës dhe provave që janë administruar rrjedh se paditësi ka qenë person i hetuar për veprën penale të dëmtimit të varrezave gjë që ka qenë subjekt i diskutimit publik.

Lidhur me pretendimet në artikull se paditësi ka qenë person i dyshuar për veprën penale “dëmtim i varrezave apo kufomave”, Gjykata ka konstatuar se këto pretendime të paditurat i kanë bazuar në fakte që mbështeten në dokumente zyrtare të Prokurorisë.

Gjykata vlerëson se të paditurat gjatë procedurës kanë arritur ta dëshmojnë se deklaratimet në artikullin e publikuar se paditësi është në krye të lëvizjes vahabiste, janë mbështetur në artikujt e mediave tjera si asaj të publikuar nga “Gazeta Express”, me datë 07.12.2013 si dhe “Kosova Info”, me datë 30.09.2014. Për më tepër vet paditësi para gjykatës ka pohuar se deklaratë të ngjashme ka pasur edhe në një artikull të gazetarit Visar Duriçi të botuar në “Gazetën Express” në vitin 2014. Nga rrjedh se një deklaram i tillë i thënë në artikullin kontestues është marrë nga artikujt e botuar vite më parë dhe si i tillë ky nuk përbën lajm i cili ka mundur të ketë ndikim të keq në reputacionin e paditësit, duke qenë se e njejta çështje është trajtuar vite më parë edhe nga mediumet tjera.

Derisa deklaratimet si “zbritja e pagës prej 20 % deri në vendim të komisionit disiplinor në organizatën që ka përsipër emërimin dhe shkarkimin e imamëve nëpër të gjitha xhamitë e Kosovës”, janë pohuar nga vet paditësi, ndonëse nuk i është kujtuar arsyeja për një masë të tillë.

Përkitazi disa çështje të ngritura nga të paditurat në artikullin e publikuar, përfshirë *qasje e aktivistëve të lëvizjes vahabiste në dosjet e Prokurorisë së Shtetit dhe se ka në shërbim pjesëtare brenda Policisë së Kosovës*, e edhe “*se kjo rrymë ka arritur të krijoj kampe rekrutimi të xhihadistëve, e edhe është e lidhur me krimin e organizuar prej trafikëve të drogës e deri te haraçi kundër bizneseve, derisa nuk përjashtohet implikimi i pjesëtarëve të kësaj lëvizje edhe në krime si shantazhi e deri tek rrahjet brutale të pjesëtarëve të besimeve të tjera*”, Gjykata vlerëson se të njejtat i referohen lëvizjes vahabiste e cila operon në regjionin e Pejës dhe në fokus ka pasur pjesëtarët e saj në përgjithësi. Ndaj edhe pjesë të artikullit duhet të lexohen me kujdes dhe



jo të ndërlidhen me emra të përveçëm përkatësisht të paditësit siç ka pretenduar i njejtë në kërkesën e tij.

Gjykata merr parasysh parimin se barra e provës, konform nenit 6 paragrafit 1 të LCKSHF-së, kur kemi të bëjmë me çështje të interesit publik bie mbi vet paditësin, megjithatë vë në pah përjashtimin nga ky rregull sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen se *“Në veprat e shpifjes dhe fyerjes që përfshijnë deklaratatë të një interesi publik, i padituri do të mbajë barrën e provave se ai/ajo ka vepruar me përgjegjësi në publikimin e deklaratës”*.

Me rastin e vlerësimit të një publikimi të një artikulli, edhe kur kemi të bëjmë me çështje të interesit publik, Gjykata duhet të vlerëson shkallën se sa një gazetar/publicist ka vepruar në mirëbesim. Më tej, vlen të theksohet se GJEDNJ ka garantuar lirinë e medias duke u shprehur në mënyrë të përsëritur se *“kërkesa e përgjithshme që gazetarët të distancohen sistematikisht dhe formalisht nga përmbajtja e një citimi që mund të çojë në fyerje apo provokim të të tjerëve, apo të dëmtojë reputacionin e tyre nuk pajtohet me rolin e shtypit për të ofruar informacion mbi çështjet e ditës, opinionet dhe idetë”*. Tujtë, duke marrë parasysh *“funksionin themelor që përmbush shtypi në një shoqëri demokratike”*, GJEDNJ ka konstatuar se, edhe pse *“shtypi mund të tejkalojë kufij të caktuar, veçanërisht sa i takon reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve dhe nevojës për të parandaluar zbulimin e informacionit të fshehtë, detyra e tij është, sidoqoftë, të përcjellë në përputhje me detyrimet e përgjegjësitë e tij informacione dhe ide mbi të gjitha çështjet me interes publik”* Poshtu GJEDNJ ka thekson se e drejta për mbrojtjen e reputacionit është e drejtë e mbrojtur nga Neni 8 i Konventës, si pjesë e së drejtës për të respektuar jetën private. Megjithatë, që të hyjë në lojë neni 8, sulmi kundër reputacionit të personit duhet të arrijë një nivel të rëndë e mënyrë të tillë që të shkaktojë paragjykim të gëzimit të së drejtës së respektimit të jetës private nga individit.

Gjykata në rastin në fjalë ka arritur në përfundim se artikulli kontestues përveç se ka shtjelluar një çështje në interes publik, nuk ka pasur për qëllim dëmtimin e reputacionit të paditësit. Siç edhe është theksuar edhe më herët artikulli në fjalë është shërbyer me provën nga Prokuroria, e edhe në dy artikuj të mëhershëm të publikuara, e të cilët veç tjerash janë referuar edhe në raportin e inteligjencës ndërkombëtare, e të cilat artikuj konsiderohen si burime të artikullit kontestues. Për më tepër, GJEDNJ në rastin e Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës, kishte konkluduar se gazetarëve nuk duhet t’iu kërkohet të ofrojnë prova lidhur me bazën faktike të të thënave në artikujt e tyre, në rastet kur autori raporton për atë që thuhet nga të tjerët. Në rastin e larupërmendur, për aq sa autorit i ishte kërkuar të dëshmonte vërtetësinë e deklaratave të tij, ai, sipas mendimit të GJEDNJ, ishte përballur me një obligim të paarsyeshëm, në mos të pamundur. Prandaj, sipas GJEDNJ në rastet e tilla nuk mund të kërkojnë që gazetarët të veprojnë si gjykata penale, ashtu që të konstatojnë drejtë dhe saktë gjendjen faktike, pasi që roli i gazetarisë halamtuese është pikërisht informimi dhe alarmimi i publikut për lajme të këqija të interesit të përgjithshëm, kur mediat t’i marrin informatat e tilla. Përfundimi i Gjykatës se informacionet e marra nga artikuj të tjerë e të cilat kanë përdorur disa burime të informacionit, nuk përbëjnë shpifje dhe fyerje, është bazuar edhe në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Rev.nr.390/2023 i datës 01.11.2023 në të cilin ishte konstatuar se *“i padituri nuk ka për detyrim që paditësit t’ia kompensoj dëmin mbi bazën e shpifjes, për shkak të informacionit shpifës ndaj personalitetit të paditësit në mënyrë publike, [...] për arsye se me këtë rast rezulton se deklaratatë*

*e të paditurit ndaj paditësit e dhënë në një gazetë, e cila në artikullin e vet ka përdorur edhe disa burime tjera informacioni dhe deklaratat e të paditurit nuk përbën shpifje dhe fyerje, por se mund të konsiderohet një çështje e ngritur në interesin e përgjithshëm”.*

Poashtu gjatë gjithë procedurës nuk është arritur të vërtetohet se paditësi ka pësuar ndonjë dëm, përkatësisht se ekziston lidhja kauzale mes publikimit të artikullit dhe dëmit. Derisa i njëjti në padi ka pretenduar se për artikullin në fjalë është njoftuar me datë 15.04.2016, gjatë seancës kur është dëgjuar në cilësi të palës vet ka deklaruar se shqetësimi ka filluar që ditën kur është publikuar lajmi. Për Gjykatën është e qartë se ka kaluar një kohë e gjatë dhe se rikujtimi i ngjarjeve është më i vështirë, mirëpo nëse vërtetë një artikull ka krijuar shqetësim tek paditësi siç pretendohet, atëherë medoemos do të mbahej mend saktë se si dhe kur ka ndodhur shqetësimi. Tutje, paditësi ka theksuar se në profilin e gazetares tani të paditurës së dytë është fyer nga persona të caktuar me emër e mbiemër, si dhe është linçuar ai dhe familja e tij. Mirëpo, derisa ka pretenduar që ka pasur thirrje me të cilat i është rrezikuar jeta nuk ka parashtruar ndonjë provë për të dëshmuar se i ka njoftuar organet e hetuesisë. E poashtu nga Vendimi me numër 33/16 i datës 07.01.2016, konstatohet se të njëjtit i është vazhduar kontrata e punës, pozitivë të cilën vazhdon ta mbaj, nga rrjedh se artikulli në fjalë nuk ia ka dëmtuar reputacion e as dëmtuar autoritetin si kryeimam.

Duke i pasur parasysh të gjeturat si më lartë, Gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se e tillë e njëjta duhet të refuzohet.

Gjykata i ka refuzuar propozimet e palës paditëse për dëgjimin e dëshmitarëve Teuta Mulla – Goga dhe Sabri Bajgora, pasi që ka vlerësuar se dëshmia e dëshmitarëve nuk është provë relevante për përcaktimin e dhimbjeve shpirtërore, respektivisht për rrethanat e ekzistimit të shpifjes.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u bazua në dispozitat e nenit 452 të LPK-së, ashtu që paditësi si palë gjyq humbëse detyrohet të paditurave t’ua paguaj shumën prej 312.00 €, dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi në shumë prej 312.00 €. Ndërsa nuk ia ka njohur shpenzimet për përfaqësim në tri seanca gjyqësore, duke qenë se të paditurit nuk janë përfaqësuar nga përfaqësuesi i regjistruar në OAK.

Nga sa u theksua më lartë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C.nr. 895/2016, datë 19.01.2024.



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.